



REPUBLIKA E KOSOVES
LIPJAN



VISIT LIPJAN GADIME


🏠 Rr. Shqipëria 28, 14000 Lipjan, Kosovë

☎ 038 200 41 508

✉ infokomuna.lipjan@rks-gov.net

🌐 <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

*Përjetoni Shpellën e mermertë në Gadime,
një shpellë unike, e rrallë dhe një nga
shpellat më të bukura*






SHPELLA E MERMERTË NË GADIME, **LIPJAN**

Shpella para-historike e mermerit në Gadimes u formua 80 milion vite më parë dhe paraqet fenomen karstik unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Është e zhvilluar në një thjerrëz të gëlqerorëve me moshë paleozoike të mermerizuar me dimensione të vogla hapësinore e ndërthurur në rreshtet permo-triasike. Fakti se kanalet, galeritë dhe boshllëqet e kësaj shpelle janë krijuar në mermer paleozoiku e bënë këtë shpellë unike dhe të rrallë në botë. Pasuria e shpellës, e cila e bën atë unike, është prania e aragonitëve, të cilat, si zbukurime shpellash, janë ngjarje të rralla.

Kristalët e këtyre zbukurimeve në shpellë shfaqen në galerinë e Aragonitit e cila karakterizohet nga forma dhe drejtime të ndryshme të shpellës që e bëjnë shpellën veçanërisht interesante dhe tërheqëse.

Shpella e mermertë e Gadimes ndodhet në fshatin Gadime e Ulët , në Komunën e Lipjanit. Ajo u zbulua në vitin 1966 nga një fshatar dhe që nga viti 1976 u hap për turizëm. Afërsishtë 1500 m gjatësi e shpellës janë eksploruar dhe mund të vizitohen nga turistët. Shpella ka tri kate: kati i mesëm që është për vizitorë, kati nënujor dhe kati i sipërm I cili thuhet te jet ende më i bukur por që ende nuk është eksploruar dhe përgatitur për visitorë. Gjatë verës temperatura në brendi të shpellës është konstante 13 gradë celsius dhe gjatë dimrit 11-13 gradë. Hyrja në shpellë ndodhet në 580 metra mbi nivelin e detit.







Ka një numër të vogël shpellash në botë në të cilat kristalet aragonit shfaqen aq të mëdha në vëllime dhe forma të ndryshme. Ata janë të orientuar në të gjitha drejtimet dhe disa kristale kanë një gjatësi deri në 30 cm.

*Ka më shumë se 25 liqene të përhershme.
Shumica e tyre ndodhen në mermeret
kompakte dhe ato janë liqenet më të
thella.*





Në aspektin hidrologjik, shpella Gadime është shumë e pasur me ujëra nëntokësore. Në të njëjtin horizont ka të gjitha llojet e rrjedhave ujore: të kondensuar, që pikon, që rrjedhë dhe ujërat e qëndrueshme, duke e kthyer shpellën Gadime në një shpellë unike hidrologjike.










Veqantia e shpellës së mermerit në Gadime me një sistem kompleks sallash, dhomash dhe galerish me lloje të rralla kristalesh i solli kësaj shpelle një famë ndërkombëtare.









Stalaktitet dhe stalagmitet


Stalaktitet dhe stalagmitet takohen dhe rriten së bashku.

Stalaktitet janë një formacion i formuar në formë akulli që rriten të varuara në tavanin dhe muret e shpellës dhe formohen nga mineralet të cilat bien me rrjedhjen e ujit nëpër tavanin e shpellës.

Stalagmitet janë depozita minerale që kondenzohen dhe rriten nga uji i cili pikon në dyshtemenë e shpellës (Romeo dhe Gjylieta).







VISIT GADIME

Lipjan - GADIME 9.4KM